

Data: 24/03/2023

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROKURIMIT: "Rehabilitim i shtresave të mbulesës së Pallatit të Kulturës"
KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Punë ndërtimi
kodi 45

VLERA E FONDIT LIMIT:

4,693,638(katër milion e gjashtëqind e nëntëdhjetë e tre mijë e gjashtëqind e tridhjetë e tetë)
lekë pa TVSH, për procedurën me objekt “ **Rehabilitim i shtresave të mbulesës së Pallatit të Kulturës**”,vënë në dispozicion nga të Ardhurat Lokale 2023.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Patos ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”si dhe nenit

(Shënim: përcaktoni **nëse është rasti**, aktin konkret ligjor ose nënligjor që parashikon plotësimin e ndonjë kërkesë specifike për ushtrimin e veprimtarisë profesionale që lidhet me objektin e prokurimit apo nevojën që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë, kur një gjë e tillë është e detyrueshme nga legjislacioni përkatës).

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2019,2020,2021, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se **1,877,455(nje milion e teteqind e shtatedhjete e shtate mije e katerqind e pesedhjete e pese)lekë**

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Fondi Limit: $4,693,638 \times 40\% = 1,877,455$ (nje milion e teteqind e shtatedhjete e shtate mije e katerqind e pesedhjete e pese)lekë

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarinimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike". Në përcaktimin e vlerës së xhiros autoriteti kontraktor është referuar në pikën 2, gërma (c) të Nenit 43, Seksioni III të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në ky kriter kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën

(Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen afatet për paraqitjen nga tatimpaguesit të deklaratës vjetore pranë organeve tatimore).

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2020,2021, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e

përcaktimeve ligjit nr.10091 date 5.3.2009 "Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar" i ndryshuar, ku bilancet e dy viteve te njepasnjeshme, nuk duhet te kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr.10091 date 5.3.2009 "Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar" i ndryshuar.

2.2.3. Vërtetim lëshuar për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2022, kudo ku operatori ushtron aktivitetet, sipas regjistrimit në QKB, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. Nr.9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, lidhur me afatet e kryerjes së pagesave të caktuara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore për vitin 2022.

(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Bashkia në të cilën është regjistruar sipas QKB-se).

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST dhe dokumentacioni i kërkuar do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore" i ndryshuar, në ligjin nr.9920 date 19.05.2008 "Per procedurat tatimore" i ndryshuar, neni 4, pika 2 d).

Referuar sa më sipër, njësitë e prokurimit gjykon se kriteri i vendosur nga autoriteti kontraktor lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të vërtetimit të shlyerjes së detyrimeve vendore për vitin 2022 sipas kësaj, prandaj bashkëve/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për "Sistemin e Taksave Vendore" i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t'u nënshtuar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 30% e vlerës së përllorë të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës,

ose

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se vlera e fondit limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik, duhet të paraqiten vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë si dhe dokumentat e mëposhtëm:

- i. Kontratën e Sipërmarrjes,
- ii. Situacion përfundimtar të objektit,
- iii. Aktin e Kolaudimit të objektit,
- iv. Formular Vlerësimi nga Investitori sipas Shtojcës nr.9

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqiten vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve si dhe dokumentat e mëposhtëm:

- i. Kontratën e Sipërmarrjes,
- ii. Situacion përfundimtar të objektit,
- iii. Aktin e Kolaudimit të objektit,

(Shënim: të përcaktohen dokumentet konkrete që kërkohen për të dëshmuar përvojën e mëparshme të ngjashme me sektorin privat, të cilat janë të nevojshme dhe i shërbejnë AK për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat 30% të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose jo më e vogël se vlera e fondit limit, për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

$$4,693,638 \times 30\% = 1,408,091$$

Shënim: (Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi).

2.3.2 Liçensat profesionale të shoqërisë lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës, referuar preventivit të punëve si dhe llojit të punëve të parashikuara në të duhet të ketë keto pika në

licensen profesionale .Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastruktues dhe Energjise, ne baze te VKM Nr 42 dt 16.01.2008 i ndryshuar, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

- a. NP-2: Ndërtime civile dhe industriale “Kategoria A”.
- b. NP-3: Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada. “Kategoria A”.
- c. NS-1: Punime për prishjen e ndërtimeve “Kategoria A”
- d. NS-4: Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese “Kategoria A”

Ne rast bashkimi operatoresh secili duhet te disponoje kategorite e licences sipas marreveshjes se bashkepunimit.

- **NP-2: Ndërtime civile dhe industriale** “Kategoria A”.

Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje të sakta në objekte ku zhvillohen aktivitete njerëzore të drejtpërdrejta ose jo, kompletimi me strukturat e nevojshme dhe finitura të llojeve të ndryshme që lidhen me objektin, punime plotësuese dhe pajisje.

Përfshin në mënyrë të thjeshtuar godina banimi, shkolla, zyra, kazerma ushtrie, teatro, stadiume, godina industriale, godina për parkim, burgje, stacione hekurudhore dhe metroje, godina aeroporti me ndonjë punim special në betonarme të thjeshtë ose të paranderrur, betonim të tavaneve të hollë, membrana, kupola, depozita të varura, sillos dhe ndërtime të larta me strukturë me karakteristika të veçanta e komplekse.

- **NP. 3 Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada “Kategoria A”**

Konsiderohen zgjidhjet dhe koordinimi i punimeve të specialiteteve të nevojshme për riaftësim, konservim, konsolidim, transformim, rivlerësim, ristrukturim. Konsiderohen gjithashtu dhe finitura të llojeve të ndryshme që lidhen me objektin, punime plotësuese dhe pajisje..

- **NS. 1: Punime për prishjen e ndërtimeve** “Kategoria A”

Konsiderohet çmontimi i impianteve industriale dhe prishja komplet e ndërtesave me pajisje speciale ose me përdorim eksplozivi me prerje të strukturave betonarmeje dhe prishjeve në përgjithësi përfshi edhe grumbullimin e mbeturinave, ndarjen e tyre dhe riciklimin e materialeve.

- **NS-4 Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese “Kategoria A”**

Konsiderohet ndërtimi, mirëmbajtje ose ristrukturim i muraturës dhe mureve ndarës të çfarëdo lloji, tipi, përfshirë suvatimin, patinimin, bojatisjen dhe punime të ngjashme me to.

Konsiderohet vendosja në vepër, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i karpenterisë dhe punimeve prej druri, të dymve dhe dritareve të brendshme dhe të jashtme, të veshjeve të brendshme dhe të jashtme të

dysHEMEVE TË TIPEVE TË NDRYSHME DHE ME MATERIALE TË NDRYSHME DHE TË PUNIMEVE TË REALIZUARA ME DORË, ME METAL, DRU, MATERIAL PLASTIK DHE MATERIAL XHAMI OSE TË NGJASHËM.

KONSIDEROHET VENDOSJA NË VEPËR, MIRËMBAJTJA DHE RISTRUKTURIMI I IZOLIMIT TERMIK DHE AKUSTIK, NËNÇATITË DHE MBROJTJA NGA ZJARRI, IZOLIMI I NATYRAVE TË NDRYSHME DHE ME MATERIALE TË NDRYSHME.

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

Kategoria e kërkuar	Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse			Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive	Vlera e punimeve kryhen në përkrahje të kategorisë përkatëse
NP-2	Ndërtime civile dhe industrial	An	Shtrese termoizoluese me beton te lehtesuar t=10 cm	m3	Kategoria A	0-20 milion
		2.200	Shtrese lluster cemento 1:2, t = 20 mm	m2		
		2.203	Veshje kornize llamarine alumini	m2		
		An	Kasete shkarkimi me llamarine alumini 0.6mm	cope		
		An	Ulluk shkarkimi vertikal me llamarine alumini Ø 80 mm	ml		
		2.197	Hidroizolim me emulsion bitumi dhe 2 shtrese k katrama	m2		
		An	Inpluver llamarine	m2		
		2.331	Suva e zakonshme fasade mur tulle ~ 8m	m2		
		An	Rakordim I bashkimit te murit me tarracen	ml		
		An	F.V. ajrues ne tarrace (boketon ajrues Ø80, h=240 mm)	cope		
		An	F.V. shkarkues tarrace (varange tarrace)	cope		
		An	F.V. sita hekuri per perngimin e papastertive	cope		
NP-3	Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale,	An	Shtrese termoizoluese me beton te lehtesuar t=10 cm	m3	Kategoria A	0-20 milion
		2.200	Shtrese lluster cemento 1:2, t = 20 mm	m2		
		2.203	Veshje kornize llamarine alumini	m2		

	veshje fasada	An	Kasete shkarkimi me llamarine alumini 0.6mm	cope		
			Ulluk shkarkimi vertikal me llamarine alumini Ø 80 mm	ml		
		2.197	Hidroizolim me emulsion bitumi dhe 2 shtrese k katrama	m2		
		An	Inpluver llamarine	m2		
		2.331	Suva e zakonshme fasade mur tulle ~ 8m	m2		
		An	Rakordim I bashkimit te murit me tarracen	ml		
		An	F.V. ajrues ne tarrace (boketon ajrues Ø80, h=240 mm)	cope		
		An	F.V. shkarkues tarrace (varange tarrace)	cope		
		An	F.V. sita hekuri per perngimin e papastertive	cope		
N.S. 1	Punime për prishjen e ndërtimeve	An	Prishje shtrese me lluster cimentoje		Kategoria A	0-20 milion
		An	Prishje hidroizolimi			
		An	Zbritje materialesh nga tarraca			
		An	Prishje suvatimi			
		2.37/5a	Transport materiale ndertimi, dheu me auto deri 5.0 km			
N.S. 4	Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese	2.331	Suva e zakonshme fasade mur tulle ~ 8m		Kategoria A	0-20 milion
		An	Rakordim I bashkimit te murit me tarracen			

(Shënim: përcaktoni kategoritë e nevojshme të licencës, me emërtimin e tyre në përputhje me legjislacionin e fushës, duke përcaktuar edhe nivelin minimal të klasifikimit për çdo kategori, sipas vlerave të punimeve konkrete që do kryhen, si dhe institucionin që lëshon këtë licencë).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për

miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe ne baze të VKM-se Nr. 42 dt 16.01.2008 i ndryshuar.

2.3.3. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor, drejtues teknik** në licencën e shoqërisë, si më poshtë:

- a. Inxhinier ndertimi 1 (nje)

Per kete duhet te paraqes Diplome, CV, kontrate pune te vlefshme, dhe te figuroj ne listpagesen e shoqerise nga muaji Janar 2023 e ne vazhdim. ne fazen e ofertimit Operatori ekonomik ploteson formularin permbledhes te vetedeklarimit.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST dhe dokumentacioni i kërkuar do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

2.3.4. Operatori ekonomik, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe **stafin mbështetës** (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), si më poshtë:

- a. 1 (nje) punonjes të disponojë çertifikatë si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327 date 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier“.

Per kete duhet te paraqes Diplome/Certifikate, CV, kontrate pune te vlefshme, dhe te figuroj ne listpagesen e shoqerise nga muaji Janar 2023 e ne vazhdim. Ne fazen e ofertimit Operatori ekonomik ploteson formularin permbledhes te vetedeklarimit.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST dhe dokumentacioni i kërkuar do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

2.3.5. Operatori ekonomik duhet të disponojë **punonjës të specializuar/të kualifikuar**, si më poshtë:

- a. **Teknike ndertimi 1 (nje)** per kete duhet te paraqes Diplome te shkolles se mesme, kontrate pune te vlefshme ,IQT (ekuivalente) dhe te figuroj ne ne listepagesen e shoqerise nga muaji Janar 2023 e ne vazhdim
- b. **Karpentiere 2 (dy)** per kete duhet te paraqes, kontrate pune te vlefshme, IQT (ekuivalente) dhe te figuroj ne ne listepagesen e shoqerise nga muaji Janar 2023 e ne vazhdim.
- c. **Punetore te thjeshte 4 (kater)** per kete duhet te paraqes, kontrate pune te vlefshme dhe te figuroj ne ne listpagesen e shoqerise nga muaji Janar 2023 e ne vazhdim.
- d. **Hidroizolues 2(dy)** per kete duhet te paraqes, kontrate pune te vlefshme, IQT (ekuivalente) dhe te figuroj ne ne listpagesen e shoqerise nga muaji Janar 2023 e ne vazhdim.
- e. **Hidraulike 2 (dy)** per kete duhet te paraqes, kontrate pune te vlefshme, IQT (ekuivalente) dhe te figuroj ne ne listpagesen e shoqerise nga muaji Janar 2023 e ne vazhdim.

- f. **Shofere 1 (tre)** per kete duhet te paraqes, kontrate pune te vlefshme leje drejtimi, IQT (ekuivalente) dhe te figuroj ne ne listpagesen e shoqerise nga muaji Janar 2023 e ne vazhdim.
- g. **Manovratore 1(nje)** per kete duhet te paraqes, kontrate pune te vlefshme leje drejtimi, IQT (ekuivalente) dhe te figuroj ne ne listpagesen e shoqerise nga muaji Janar 2023 e ne vazhdim.

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesë:

- diplome,
- kontrata pune,
- deshmi kualifikimi
- Ne raste kur makinerit disponohen me qera, keta punonjes do te jene te kontraktuar.

.....
(Shënim: listoni dokumentacionin provues që dëshmon disponimin e stafit kryesor, mbështetës dhe të specializuar/kualifikuar të kërkuar, dhe nëse është rasti kërkesat për licencat profesionale individuale, apo certifikimet/kualifikimet që duhet të disponojnë anëtarët e stafit, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi, si dhe insitucionin që lëshon këto licenca apo certifikime/kualifikime).

Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të vlerësimit të preventivit dhe të grafikut të punimeve.

- **Inxhinieri i Ndertimit** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve te objektit qe prokurohet për secilin nga zërat e punimeve për ndërtimin e objektit, zberthimin e projektit konstruktiv, punimet e betonit të hekurit, punimet e muraturës, shtresave të rruges etj. Ai është përgjegjës për cilësinë e materialeve si psh të betonit, hekurit etj.
- **Tekniku ndertimi (ose inxhinier zbatimi)** eshte pergjegjes per organizimin e zbatimin e punimeve te ndertimit te objekti per te gjithë zerat e punimeve te objektit, zberthimin e sakte te projektit, punimet e ndertimit dhe per cilesine e materialeve qe vendosen ne object.
- **Karpiere** eshte pergjegjes per pergatitjen e armatures se derases dhe betonimin e strukturave te ndryshme b/a ne objektik qe prokurohet.
- **Hidroizoluesi** eshte personi pergjegjes per kryerjen e punimeve te hidroizolimit te brendshem dhe te jashtem sipas projektit te miratuar dhe pergjigjet per materialet qe vendosen ne objektin qe prokurohet
- **Hidrauliku Hidrauliku** jane personat pergjegjes pergjegjes per montimin e linjave hidraulike ne objekt
- **Puntore te thjeshte** jane pergjegjes per pergatitjen e materialeve baze per cdo ze pune dhe afrimi ne vendin ku punohet nga specialist perkates per zbatimin e punimeve te ndertimit ne objektin qe prokurohet.
- **Shofere** jane personat pergjegjes per drejtimin e makinerive ne kantiar dhe jashte kantierit per furnizimin dhe transportin e materialeve te nevojshme per objektin qe prokurohet. Ne raste kur makinerit disponohen me qera, keta punonjes do te jene te kontraktuar.

- **Manovratore** jane personat pergjegjes per drejtimin e makinerive ne kantier dhe jashte kantierit per furnizimin dhe transportin e materialeve te nevojshme per objektin qe prokurohet. Ne raste kur makinerit disponohen me qera, keta punonjes mund te jene te kontraktuar

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të vlerësimit të preventivit dhe të grafikut të punimeve.

2.3.6. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej **minimalisht 14 (katërmbëdhjete) persona.**

Periudha për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

- Vertetim te leshuar nga Dega e Tatimeve te Rrethit ose nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqerore te rrethit perkates ose me vule elektronike .*
- Listepagesat per periudhen e mesiperme (E-sig 25)*

***Shënim:** Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST dhe dokumentacioni i kërkuar do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.*

Shënim: Argumentimi mbi numrin e punonjesve.

Ne objektin “**Rehabilitim I shtresave të mbuleses se Pallatit te Kultures**” proceset e punes klasifikohen ne keto kategori:

a) Punime per mobilizimin e kantierit

Ne keto punime perfshihet pergatitja e kantierit per fillimin e punimeve. Gjate kesaj kohe do t percaktohen furnitoret dhe vendet e depozitimit te materialit. Do te stukturohet organika e njerezve qe do te punojne ne kantier dhe do te behet konturimi i kantierit me hyrje-daljet e tij. Afati i parashikuar 6 dite pune. Puntore te angazhuar: 1 specialist dhe 2 puntore. Makineri Kamiocine dhe/ose pick-up.

b) Punime prishje.

- **Volumi I punimeve** **1500 m2.**
- **Koha e nevojshme per perfundimin e punimeve** **522 op.**
- **Norma mesatare e punimeve** **0.03 m3/op**

Keto punime perfshijne prishjen e shtresave dhe strukturave ekzistuese apo zerave te vecante ne preventiv. Orari nominal mesatar per punimet e prishjes eshte ne trupin e rruges eshte rreth 48.13 ore/m3. Referuar grafikut qe parashikon afatin 12 dite pune,

fuqia puntore duhet te jete 6 here me shume, ose 2specialiste dhe 4 puntore. Makinerite qe nevojiten jane:, 1 kamiocine deri ne 3.5 ton, trako, matrapik elektrik, depozite uji, pompe uji etj.

c) Punime hidroizolimi i tarraces.

- **Volumi I punimeve** **1500 m2.**
- **Koha e nevojshme per perfundimin e punimeve** **134 op.**
- **Norma mesatare e punimeve** **0.754 m2/op.**

Keto punime perfshijne vendosjen e shtresave te hidroizolimit dhe termoizolimit ne tarrace. Parashikimi i kohezgjatjes se punimeve 5 dite pune, orari mesatar i punimeve 1.33 ore/m2. Per realizimin e ketyre punimeve ne afatin e parashikuar nevojiten 2 specialiste dhe 2 puntore. Makineri dhe mjete te angazhuara per kete proces pune: 1 kamiocine deri ne 3.5 ton, 1 gjenerator, i autobetoniere, i pompe betoni, 1 kanello me gaz, 2 bombula gazi etj.,.

d) Punime per demobilizimin e kantierit

Per demobilizimin e kantierit duke qene se jane disa nenobjekte, me perfundimin e secilit nenobjekt behet largimi i makinerive dhe pajisjen nga vendi i ndertimit (minikantieri) per dorezimin e punimeve te realizuara eshte parashikuar nje periudhe kohore prej 6 dite pune. Puntore te angazhuar per realizimin ne afat te ketij demobilizimi duhen 1 specialist +1 puntor. Makineri dhe pajisje te nevojshme per kete faze: 1 kamioncine.

Referuar kategorise se punimeve si dhe afatit, stafi i kerkuar duhet te jete:

- **Teknike ndertimi** **1(nje)**
- **Karpentiere** **2 (dy)**
- **Puntore te thjeshte** **4 (kater)**
- **Hidroizolues** **2 (dy)**
- **Hidraulike** **2 (dy).**
- **Shofere** **1 (nje).**
- **Maovratore** **1 (nje)**
- **Drejtues Teknik** **1 (nje)**

TOTALI = 14 Persona ne Staf (katermbedhjete).

2.3.7. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

- **Kamion veteshkarkues me vinc me kapacitet mbajtes deri 8 ton** **cope 1 (nje)**
- **Kompresor** **cope 1 (nje)**
- **Betoniere kantieri** **cope 1 (nje)**
- **Depozite uji >1000 litra** **cope 1 (nje)**
- **Gjenerator 3.5kWA** **cope 1 (nje)**

Ofertuesi për makineritë, të cilat janë në pronësi ose me qera, duhet të paraqesë, dokumentacionin e mëposhtem:

- lejen e qarkullimit.
- certifikatat e pronësisë,
- siguracionin e mjetit.

- kolaudimin,
 - certifikatë transporti
 - fotografi të mjetit te paraqitura. (të cilat duhet të jenë në emër të shoqërisë ose në emër të qeradhënësit) .
- Për mjetet dhe pajisjet te cilat nuk kanë leje qarkullimi, Ofertuesi duhet të paraqesë:

- kontratë noteriale të blerjes,
- fatura tatimore të blerjes ose dokumenta zhdoganimi të mjetit.

Pranohet marrja me qera ose huapërdorje e mjeteve të mësipërme, me kusht që kontrata e qeramarrjes ose huapërdorjes të jetë bërë para noterit, me afat vlefshmërie brenda afatit të zbatimit të punimeve për këtë objekt.

- a) *Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit, , leje qarkullimi, plus certifikatën e kontrollit teknik , siguracionin e mjetit (të vlefshme), dhe për mjetet e siguruara me qera, dokumenti që vërteton regjistrimin e tij, leje qarkullimi, plus certifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit,(të vlefshme) , të shoqëruar me kontratën përkatëse të qerasë/furnizimit noteriale,, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi.*
- b) *Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre.*
- c) *Per mjetet e marra me qera apo huapërdorim duhet te saktësohet përfshirja apo jo e manovratorit ne kete kontrate.*
- d) **Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruara sipas shtojcës perkatëse. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese).**

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar numrin e punonjësve dhe të mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, konkretisht.

2.4 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.4.1 Certifikat ISO:

- a) **ISO 9001-2015 – Standard per Sistemin e Menaxhimit te Cilesise (e vlefshme) ose ekuivalente**, Certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi:

Kjo certifikatë mundëson që shoqëria të punojë me standarte e cilësi , e cila mundeson implikimi në menaxhim, identifikimi i riskut dhe mundësive, sigurimi i konkurrencës për personelin e shoqërisë, mirëmbajtja e pajisjeve dhe infrastrukturës, matja e kënaqësive të klientëve, përgjigje ndaj ankesave të marra dhe vlerësimi i furnitorëve, marrëdhënie biznesi me partnerët e njohur apo një imazh më të mirë në sytë e klientëve.

- b) **ISO 14001 - 2015 - Standard per Sistemin e Menaxhimit te Mjedisit (e vlefshme) ose ekuivalente**, Certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi:

Kjo çertifikatë mundëson që shoqëria e cila punon/ushton aktivitetin në një zonë prodhimi; e cila përfshin larminë e ajrit, tokës, ujit dhe burimeve natyrore, bimëve dhe kafshëve, dhe qeniet njerëzore dhe shoqërimin e tyre me njëri-tjetrin. Iso 14001 është standardi universal i procesit të monitorimit të përpjekjeve të një organizate drejt mjedisit të saj dhe në një kuptim tjetër të hapave përpara. Është një ndërveprim sistematik që lejon të zbatohet duke i kushtuar vëmendje efekteve rreth tij gjatë periudhës nga faza e parë e prodhimit deri te dorëzimi tek perdoruesit e ketij objekti, marrëdhënie biznesi me partnerët e njohur apo një imazh më të mirë në sytë e klientëve.

- c) **ISO 45001-2018 Standart per Menaxhimin e Shendetit dhe Sigurise ne Pune (e vlefshme) ose ekuivalente**, Certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zërave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes).

Argumentimi:

Sistemi i manaxhimit te sigurise dhe shendetit ne vendet e punes mundeson qe çdo kompani duhet të mbrojë shëndetin dhe sigurinë në punë për të gjithë punonjësit, e cila përfshin vlerësimin e rreziqeve të aksidenteve në punë, vendosjen e masave në fushën e shëndetit dhe sigurisë, inkurajimin e pjesëmarrjes së punonjësve në përpjekjet për të përmirësuar kushtet e punës, zbatimin e masave për të zvogëluar rreziqet e aksidenteve dhe sëmundjeve si dhe hetimin e incidenteve.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 44, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”(i ndryshuar), si dhe ne Kodin te punes, ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995, i ndryshuar, Ligjin nr.10237 date 18.02.2010 "Per sigurine dhe shendetin ne pune", VKM nr. 562, datë 03.07.2013 “Për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit në përdorimin e pajisjeve të punës në vendin e punës”, VKM nr. 563, datë 03.07.2013 "Për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit për përdorimin e pajisjeve mbrojtëse individuale në vendin e punës”, VKM nr.312, datë 5.5.2010 "Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier si dhe ne mbeshtetje te natyres se objektit te prokurimit.

(Shënim: Autoriteti/enti kontraktor, në varësi të natyrës së objektit të prokurimit, mund të përcaktojë kritere të tjera të vecanta, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses

të kontratës, duke argumentuar teknikisht dhe ligjërisht çdo kriter, duke përcaktuar, sipas rastit, aktin ligjor/nënligjor që parashikon domosdoshmërinë e kriterit në fjalë).

Specifikimet teknike janë bere për përmbushjen e nevojave të Autoritetit Kontraktor. Materialet i kanë specifikimet e tyre cilësore dhe sasiore sipas zerave të secilit në preventive dhe në specifikimet teknike.

Të gjitha materialet e përshkruara në preventiv duhet të jenë sipas specifikimeve teknike. Në rast se një nga zërat e preventivit është e shkruar me emra marke automatikisht do të pranohet edhe një produkt ekuivalent.

Specifikimet teknike u hartuan nga **DREJTORIA E HARTIMIT TË PROJEKTEVE, SHERBIMEVE DHE EMERGJENCAVE CIVILE** duke marr në konsideratë nevojat e Autoritetit Kontraktor, në përputhje me përcaktimet e nenit 36 “Specifikimet teknike” të Ligjit Nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, e Nenit 40 pika 2, si edhe të Nenit 44 “Kërkesat e cilësisë” të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Në përfundim, Njësia e Prokurimit vendosi unanimitisht miratimin e dokumenteve të tenderit dhe si afat përfundimtar për dorëzimin e ofertave përcaktoi datën **06/04/2023, ora 11:00.**

Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit me objekt **“Rehabilitim i shtresave të mbulesës së Pallatit të Kulturës”**,

Bashkëlidhur këtij procesverbali:

Dokumentat e tenderit.

NJESIA E PROKURIMIT: